



**UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHEVE TË HUAJA**



**UDHËRRËFYESI I  
STUDENTIT**



## **FGJH-ja përbëhet nga 7 DEPARTAMENTE:**

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja (FGJH), themeluar në vitin 1957, është një nga fakultetet kryesore të Universitetit të Tiranës (UT).

Ndër vite FGJH-ja është zgjeruar me krijimin e departamenteve të reja.

- Departamenti i Gjuhës Angleze
- Departamenti i Gjuhës Frënge
- Departamenti i Gjuhës Italiane
- Departamenti i Gjuhës Gjermane
- Departamenti i Gjuhës Spanjolle
- Departamenti i Gjuhës Greke
- Departamenti i Gjuhëve Sllave e Ballkanike
  - Dega e Gjuhës Turke
  - Dega e Gjuhës Ruse

# PSE?

## Fakultetin e

## Gjuhëve të Huaja

Mjedise të përshtatshme, moderne e të pajisura me teknologji inovative, që ju vijnë në ndihmë gjatë procesit të mësimdhënies e të mësimnxënies.

Pedagogë me përvojë shumëvjeçare në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, si edhe të pakursyer në çdo kohë për t'iu përgjigjur kërkesave dhe nevojave të studentëve.

Mbështetje dhe këshillim i vazhdueshëm për studentët gjatë gjithë karrierës së tyre studimore dhe më tej.

Mundësi punësimi brenda dhe jashtë vendit.

Bibliotekë fizike dhe digjitale e pasur dhe e përditësuar me tituj bashkëkohorë të autorëve më në zë.

Laboratorë didaktikë dhe përkthimi që u shërbejnë studentëve për të vënë në zbatim njohuritë teorike të përftuara në disiplinat e ndryshme që ofrojmë.

Jetë e pasur studentore me aktivitete dhe klube artistike e sportive, veprimtari kulturore, konkurse, ekskursionë, projekte, seminare, konferenca kombëtare e ndërkombëtare.



## VIZIONI

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja do të vijojë të konsolidojë pozicionin e tij si institucioni kryesor me kontributin më të madh në vend në mësimin e gjuhëve të huaja, duke prodhuar specialistë dhe profesionistë, që i përgjigjen kërkesave të tregut dhe njëkohësisht ndihmojnë në zhvillimin e vendit në intergimin evropian.

Përmes mësimin, shërbimit dhe kërkimit, FGJH-ja synon të kontribuojë në formimin cilësor të studentëve, në përmbushjen personale të tyre, në krijimin e mirëkuptimit të ndërsjellë të harmonisë shoqërore dhe ndjenjës së qytetarisë globale të shekullit XXI si dhe të shërbejë si urë komunikimi për çështjet me interes kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, duke krijuar një hapje dhe ndjeshmëri ndaj kulturave të ndryshme në fushën e gjuhëve, letërsisë dhe komunikimit.

FGJH -ja do të përshtasë me shpejtësi ofertën e programeve akademike në përputhje me kërkesat e tregut. Zhvillimi i kurrikulës është thelbësor për cilësinë e mësimdhënies, ndaj institucioni ynë synon të vazhdojë të përforëcojë qasjen e të mësuarit, për të garantuar që të diplomuarit tanë të kenë aftësitë e nevojshme si qytetarë të shekullit të njëzet e një.

## MISIONI

Të përgatisë studentët me kompetenca në mësimdhënie, komunikim të gjuhëve dhe kulturave të ndryshme, për t'i bërë ata anëtarë të ndjeshëm në një shoqëri globale.

Të rrisë aftësinë komunikuese të studentëve përmes programeve sfiduese, metodologjive inovative të mësimdhënies dhe mbështetjes së procesit mësimor dhe të nxënimit me teknologjinë moderne bashkëkohore.

Të krijojë dhe zhvillojë një mjedis akademik që nxit mirëkuptimin dhe ndërveprimin ndërkulturor në shoqëri dhe promovon shkëmbime gjuhësore, akademike dhe kulturore.

Të zhvillojë dimensionin ndërkombëtar për t'u bërë një mediator ndërmjet kulturës kombëtare dhe botërore.

Të ofrojë shërbime mësimi, përkthimi, trajnimi dhe ekspertizë në fushën e gjuhëve të huaja.

Të nxisë bashkëpunimin akademik me institucionet homologe dhe bashkëpunimin për ndërveprimin në shoqëri, si dhe promovimin me institucionet qeveritare, organizatat profesionale e komunitetet lokale në shkëmbimet gjuhësore, akademike e kulturore.



**Prof. Dr. Artan Hoxha**  
Rektor i Universitetit të Tiranës

Universiteti i Tiranës është krijuar në vitin 1957, si institucioni i parë universitar i arsimit të lartë dhe i kërkimit shkencor në Shqipëri.

Universiteti i Tiranës synon të mbetet model i arsimit të lartë publik, i karakterizuar nga përgatitje rigoroze akademike dhe kërkim i thelluar shkencor, një institucion arsimor i zgjedhjes së parë për studentët e angazhuar në transformimin e jetës së tyre dhe të shoqërisë.

Parimet nga të cilat udhëhiqet Universiteti i Tiranës janë:

- *Liria e mendimit dhe e shprehjes*
- *Autonomia në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor*
- *Transparenca*
- *Meritokracia*
- *Kolegjialiteti*
- *Mosdiskriminimi*

Mbështetur në traditat arsimore e shkencore më të përparuara të vendit dhe ato ndërkombëtare, Universiteti i Tiranës ka zënë një vend të denjë ndër institucionet arsimore e shkencore në vend.

UT-ja është një universitet publik, që ofron gamë të plotë të programeve të nivelit Bachelor, Master dhe Studime Doktorale. Universiteti kontribuon në zhvillimin e shoqërisë përmes tri shtyllave të misionit të arsimit të lartë publik: kërkim shkencor, edukim dhe shërbim ndaj publikut, të cilat vazhdimisht e pasurojnë dhe e informojnë njëra-tjetrën.

Universiteti ofron edukim me në qendër studentin, si dhe nxit rritjen personale dhe intelektuale të tyre për karrierë produktive me synimin për t'i bërë qytetarë të përgjegjshëm në një shoqëri globale.

## ORGANET DREJTUESE

Organi më i lartë drejtues akademik i Universitetit është Senati Akademik. Autoritetet drejtuese akademike janë:

- Rektori
- Dekani
- Përgjegjësi i Departamentit

Organi më i lartë drejtues administrativ është Bordi i Administrimit. Autoritetet drejtuese administrative janë:

- Administratori i Institucionit
- Administratori Njësisë Kryesore

*Organe të tjera kolegjiale janë: Rektorati, Dekanati dhe Këshilli i Etikës*



**Prof. Dr. Esmeralda Kromidha**  
Dekan i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja

1. Zhvillimi i Njësive Bazë të FGJH-së dhe rritja e cilësisë së proceseve akademike.
2. Rritja e cilësisë së mësimdhënies duke integruar kërkimin shkencor.
3. Vendosja e studentëve në qendër të veprimtarisë së Fakultetit.
4. Konsolidimi i autonomisë financiare dhe garantimi i një infrastrukture bashkëkohore.
5. Fuqizimi i FGJH-së nëpërmjet partneriteteve dhe bashkëpunimeve me institucione brenda dhe jashtë vendit.

Personeli akademik dhe studentët e FGJH-së, përbëjnë potencialin më të rëndësishëm që duhet vlerësuar dhe promovuar, duke u mbështetur në punën mësimore, në atë kërkimore-shkencore, si edhe në ushtrimin e lirisë akademike.



**Prof. Dr. Saverina Pasho**  
Zv. Dekan për Ciklin e Tretë të Studimeve,  
Kërkimin Shkencor dhe Botimet



**Dr. Drita Rira**  
Zv. Dekan për Ciklin e Dytë të Studimeve, Koordinatore  
Akademike Erasmus+ dhe Marrëdhënieve me Jashtë



**Dr. Ogerta Stroka (Koruti)**  
Zv. Dekan për Marrëdhënie me Studentët,  
Publikun dhe Këshillimin e Karrierës



**Dr. Alnida Koroshi**  
Zv. Dekan për Ciklin e Parë të Studimeve,  
Cilësinë dhe Kurrikulat



**Prof. Dr. Viktor Ristani**  
Përgjegjës Departamenti



## DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE

### Cikli i Parë i Studimeve:

**Bachelor në Gjuhë Angleze me profile:**

- Gjuhë Angleze
- Përkthim dhe Interpretim
- Studime Britanike dhe Amerikane

### Cikli i Dytë i Studimeve:

**Master i Shkencave:**

- Mësuesi e Gjuhës Angleze për Arsimin e Mesëm të Lartë
- Gjuhë dhe Komunikim Ndërkulturor e Turistik
- Përkthim Teknik - Letrar dhe Interpretim
- Diplomë e dyfishtë me Universitetin Sorbonne Paris Nord, Fusha: Trajtimi Automatik i Gjuhëve, Trajtimi informatik dhe gjuhësor i dokumenteve të shkruara.

**Master Profesional:**

- Përkthim profili: Përkthyes
- Master i delokalizuar me Universitetin e Strasburgut / ITI-RI në degën Përkthim Profesional

*Kontakte në Departament:*

*Email: [departamenti.anglishti@unilir.edu.al](mailto:departamenti.anglishti@unilir.edu.al)*

Diplomat e marra nga studentët e anglishtes të diplomuar në të tërë ciklet e studimeve në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, njihen në SHBA, Kanada dhe Evropë duke ju krijuar mundësi për studime të mëtejshme dhe/apo punësim, jo vetëm në drejtimet dhe programet e studimit të FGJH-së, por dhe në një shumëllojshmëri programesh të tjera studimi.

Gjatë këtyre viteve Departamenti i Anglishtes ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me Këshillin Britanik, Ambasadën Amerikane, Korpusin e Paqes, universitete të ndryshme në Evropë dhe më tej, duke u përfshirë në projekte të përbashkëta kërkimore-shkencore.

Departamenti organizon çdo vit konferencën e tij, ku marrin pjesë profesorët tanë, por edhe profesorë të universiteteve të tjera në vend dhe partnerët jashtë vendit. Risi është gjithashtu edhe organizimi i Konferencës Studentore, ku marrin pjesë studentë të ciklit të dytë të studimeve master.





## DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE

### Cikli i Parë i Studimeve:

#### Bachelor në Gjuhë Frënge me profile:

- Gjuhë dhe Komunikim
- Përkthim dhe Interpretim
- Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Francez

### Cikli i Dytë i Studimeve:

#### Master i Shkencave:

- Mësuesi e Gjuhës Frënge për Arsimin e Mesëm të Lartë
- Gjuhë dhe Komunikim Ndërkulturor e Turistik
- Përkthim Teknik - Letrar dhe Interpretim
- Diplomë e dyfishtë me Universitetin Sorbonne Paris Nord, Fusha: Trajtimi Automatik i Gjuhëve, Trajtimi informatik dhe gjuhësor i dokumenteve të shkruara.

#### Master Profesional:

- Master i delokalizuar me Universitetin e Strasburgut / ITI-RI në degën Përkthim Profesional

*Kontakte në Departament:*

*Email: [departamenti.frenghisht@unitir.edu.al](mailto:departamenti.frenghisht@unitir.edu.al)*

Departamenti ka bashkëpunime me Ambasadën Franceze në Tiranë, Organizatën Ndërkombëtare të Frankofonisë (OIF), Agjencinë Universitare të Frankofonisë (AUF), Kampusin Numerik Frankofon (CNF), Qendrën Rajonale Frankofone për Evropën Qëndrore dhe Lindore (CREFECO) dhe Universitete Franceze. Të gjitha këto bashkëpunime favorizojnë dukshëm konsolidimin e formimit shkencor të pedagogëve si edhe cilësinë e lartë të mësimdhënies së gjuhës e kulturës frënge, nëpërmjet shkëmbimeve dhe trajnimeve për ta dhe për studentët, si dhe larmishmërisë së veprimtarive shkencore universitare dhe pasuniversitare.

Në Departamentin e Gjuhës Frënge janë zhvilluar dhe zhvillohen veprimtari të ndryshme ekstrakurrikulare si konkurse mes studentëve për përkthimet më të mira, vënie në skenë e komedive muzikore në gjuhën frënge, realizimi dhe konceptimi i afishave me tema të frankofonisë, reportazhe informuese në gjuhën frënge nga studentë të masterit, prezantime rreth temës së të drejtave të njeriut, mbrëmje poetike, shfaqje me krijime studentësh (poezi, pjesë teatrale), si edhe në veprimtari sportive të organizuara nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja.



**Prof. Asoc. Dr. Alba Frashëri**  
Përgjegjës Departamenti







**Dr. Marsela Likaj**  
Përgjegjës Departamenti



## DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE

### **Cikli i Parë i Studimeve:**

#### **Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile:**

- Gjuhë dhe Komunikim
- Përkthim dhe Interpretim
- Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Gjermanishtfolës

### **Cikli i Dytë i Studimeve:**

#### **Master i Shkencave:**

- Mësuesi e Gjuhës Gjermane për Arsimin e Mesëm të Lartë
- Gjuhë dhe Komunikim Ndërkulturor e Turistik
- Përkthim Teknik - Letrar dhe Interpretim
- Diplomë e dyfishtë me Universitetin Sorbonne Paris Nord, Fusha: Trajtimi Automatik i Gjuhëve, Trajtimi informatik dhe gjuhësor i dokumenteve të shkruara.

#### **Master Profesional:**

- Master i delokalizuar me Universitetin e Strasburgut / ITI-RI në degën Përkthim Profesional

*Kontakte në Departament:*

*Email: [departamenti.gjermanisht@uni-tir.edu.al](mailto:departamenti.gjermanisht@uni-tir.edu.al)*

Të gjithë pedagogët janë kualifikuar në vendet gjermanishtfolëse dhe kanë përvojë shumëvjeçare në mësimdhënie. Pjesë e stafit akademik janë edhe pedagogë gjermanë, falë bashkëpunimit tashmë 30 vjeçar me Shërbimin e Shkëmbimit Akademik Gjerman (DAAD).

Departamenti organizon çdo vit aktivitete shkencore, kulturore, trajnime në fushën e mësuesisë, përkthimit, turizmit etj, duke u dhënë mundësi studentëve të përftojnë njohuri dhe të zgjerojnë horizontin, për të qenë të orientuar në tregun e punës.

Nëpërmjet pjesëmarrjes në programe të ndryshme ndërkombëtare studentëve u ofrohet mundësia e mobilitetit duke u mbështetur financiarisht për disa javë, një semestër apo një cikël studimi në universitetet partnere jashtë vendit.

Diplomat e përfuara nga programet e studimit në degën Gjuhë Gjermane njihen në Evropë, SHBA etj., gjë e cila rrit mundësinë e punësimit pas përfundimit të studimeve në këtë degë.





# DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE

## Cikli i Parë i Studimeve:

### Bachelor në Gjuhë Italiane me profile:

- Gjuhë dhe Komunikim
- Përkthim dhe Interpretim
- Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Italian

## Cikli i Dytë i Studimeve:

### Master i Shkencave:

- Mësuesi e Gjuhës Italiane për Arsimin e Mesëm të Lartë
- Gjuhë dhe Komunikim Ndërkulturor e Turistik
- Përkthim Teknik - Letrar dhe Interpretim
- Diplomë e dyfishtë me Universitetin Sorbonne Paris Nord, Fusha: Trajtimi Automatik i Gjuhëve, Trajtimi informatik dhe gjuhësor i dokumenteve të shkruara.

### Master Profesional:

- Master i delokalizuar me Universitetin e Strasburgut / ITI-RI në degën Përkthim Profesional

*Kontakte në Departament:*

*Email: [departamenti\\_italisht@unitir.edu.al](mailto:departamenti_italisht@unitir.edu.al)*

Departamenti Gjuhës Italiane, që prej fillimit të tij, ka spikatur për një aktivitet të gjallë shkencor, i cili ka lënë gjurmët e veta ndër vite, duke u shndërruar në një gurrë të pasur informacioni dhe përvoja, që do t'u vijë në ndihmë brezave të ardhshëm dhe studiuesve të rinj. Në fokus të këtyre aktiviteteve ka qenë hulumtimi, trajtimi, argumentimi, diskutimi dhe rrahja e mendimeve rreth tematikave të rëndësishme me natyrë gjuhësore, didaktike, letrare, kulturore, përkthimore, etj.

Çdo vit ne organizojmë konkursin “Attraversare la Penisola. Incontri, ricordi, suggestioni, paesaggi ed architetture da un viaggio in Italia”, ku studentit fitues i jepet një bursë për të ndjekur një kurs gjuhe dhe kulture italiane në Itali, Gemona, Udine.

Në kuadër të programit Erasmus+ studentët tanë kanë mundësi për mobilitete në të gjithë ciklet e studimit: Bachelor, Master dhe PhD në universitetet më të mira evropiane.

Ne kemi bashkëpunime me disa Universitete Italiane si: Università degli Studi di Bari, Universitetin La Sapienza, CESFORIA Centro di Studi e Formazione nelle Relazioni Interadriatiche, Università di Salerno, etj.



**Prof. Asoc. Dr. Mirela Papa**  
Përgjegjës Departamenti





**Dr. Serxho Rama**  
Përgjegjës Departamenti



# DEPARTAMENTI I GJUHËS SPANJOLLE

## Cikli i Parë i Studimeve:

**Bachelor në Gjuhë Spanjolle me profil:**

- Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Hispanik

## Cikli i Dytë i Studimeve:

**Master i Shkencave:**

- Gjuhë dhe Komunikim Ndërkulturor e Turistik
- Përkthim Teknik - Letrar dhe Interpretim
- Diplomë e dyfishtë me Universitetin Sorbonne Paris Nord, Fusha: Trajtimi Automatik i Gjuhëve, Trajtimi informatik dhe gjuhësor i dokumenteve të shkruara.

**Master Profesional:**

- Master i delokalizuar me Universitetin e Strasburgut / ITI-RI në degën Përkthim Profesional

*Kontakte në Departament:*

*Email: [departamenti.spanjisht@unitir.edu.al](mailto:departamenti.spanjisht@unitir.edu.al)*



Departamenti i Gjuhës Spanjolle për disa vite ka qenë Qendër e provimit Pasuniversitar DELE (Diploma de Español como Lengua Extranjera), diplomë e Gjuhës Spanjolle si Gjuhë e Huaj, e cila njihet ndërkombëtarisht, e organizuar nga Instituti Cervantes, me seli në Romë, në bashkëpunim me Ambasadën Spanjolle në Tiranë.

Në kuadër të programit Erasmus+, çdo vit hapen thirrje për aplikime të mobiliteteve me bursa për studentët e nivelit Bachelor, Master dhe PhD, në Universitete të ndryshme spanjolle si: Universiteti i Granadës, i Almerisë, i Huelva, Santanderit, etj.



## DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE E BALLKANIKE

### Cikli i Parë i Studimeve

#### Bachelor në Gjuhë Turke me profile:

- Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Turk
- Përkthim e Interpretim

#### Bachelor në Gjuhë Ruse me profile:

- Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Rus
- Përkthim e Interpretim

### Cikli i Dytë i Studimeve

#### Master i Shkencave në Gjuhë Turke:

- Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë
- Gjuhë dhe Komunikim Ndërkulturor e Turistik
- Përkthim Teknik - Letrar dhe Interpretim
- Diplomë e dyfishtë me Universitetin Sorbonne Paris Nord, Fusha: Trajtimi Automatik i Gjuhëve, Trajtimi informatik dhe gjuhësor i dokumenteve të shkruara.

#### Master Profesional:

- Master i delokalizuar me Universitetin e Strasburgut / ITI-RI në degën Përkthim Profesional

#### Master i Shkencave në Gjuhë Ruse:

- Gjuhë dhe Komunikim Ndërkulturor e Turistik
- Përkthim Teknik - Letrar dhe Interpretim

Shkolla Verore e Bullgarishtes është e para e këtij lloji në vendin tonë që organizohet nga Departamenti i Gjuhëve Sllave-Ballkanike e FGJH-së, në kuadër të Programit Erasmus+ që UT-ja ka me Universitetin Veliko Terno "St. Shën Kirili dhe Metodi" të Bullgarisë.

Në "Ditën e Gjuhës Ruse", e cila festohet në ditëlindjen e poetit të madh rus A. S. Pushkin, departamenti ynë në bashkëpunim me Shoqatën e Miqësisë Shqipëri-Rusi, organizon takime kulturore me temë "Gjuha Ruse: Gjuhë e Pushkinit dhe e afrimit mes kulturave".

Përmes promovimit të vlerave të gjuhës dhe kulturës ruse në këtë ditë, synohet gjithashtu të përcillen vlera të solidaritetit mes popujve me ndikime në sektorë të tjerë të zhvillimit të shoqërive dhe me impakt të drejtpërdrejtë shoqëror, ekonomik, turistik në të dy vendet.

Për t'u ardhur në ndihmë studentëve të turqishtes e më gjerë, organizohet çdo vit "Shkolla verore e osmanishtes" në bashkëpunim me Universitetin "Aydin" të Stambollit, Universitetin "Bartin" të Turqisë - Departamenti i Dialekteve Turke, me të cilin universiteti ynë ka marrëveshje Erasmus+.



**Prof. Asoc. Dr. Adriatik Derjaj**  
Përgjegjës Departamenti

*Kontakte në Departament:*

*Email: [departamenti.sllavoballkanik@unitir.edu.al](mailto:departamenti.sllavoballkanik@unitir.edu.al)*





**Prof. Asoc. Dr. Sofia Delijorgji**  
Përgjegjës Departamenti



## DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE

### Cikli i Parë i Studimeve:

#### Bachelor në Gjuhë Greke me profile:

- Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek
- Përkthim dhe Interpretim

#### Bachelor në Përkthim Greqisht - Anglisht

(në bashkëpunim me Universitetin Ionaian të Korfuzit, Greqi)

### Cikli i Dytë i Studimeve:

#### Master i Shkencave:

- Mësuesi e Gjuhës Greke për Arsimin e Mesëm të Lartë
- Gjuhë dhe Komunikim Ndërkulturor e Turistik
- Përkthim Teknik - Letrar dhe Interpretim
- Diplomë e dyfishtë me Universitetin Sorbonne Paris Nord, Fusha: Trajtimi Automatik i Gjuhëve, Trajtimi informatik dhe gjuhësor i dokumenteve të shkruara.

#### Master Profesional:

- Master i delokalizuar me Universitetin e Strasburgut / ITI-RI në degën Përkthim Profesional

*Kontakte në Departament:*

*Email: [departamenti.greqisht@uniir.edu.al](mailto:departamenti.greqisht@uniir.edu.al)*

Departamenti i Gjuhës Greke punon për realizimin e objektivave dhe synimeve si në planin e karrierës akademike, ashtu edhe në planin e mësimdhënies cilësore sipas standardeve të reja evropiane. Arritjet e këtyre synimeve e objektivave departamenti i mbështet fort në bashkëpunimin e shumëfishtë me disa Universitete të Greqisë si: Universiteti i Janinës, Universiteti Aristotelio i Selanikut, me projekte të ndryshme shkencore, me shoqata dhe fondacione të ndryshme Greke si psh: Fondacioni Aleksandros Onassis me qendër në Athinë, me Ambasadën Greke në Tiranë, dhe me shkollën “Arsakeio”, për praktikantë e studentëve të ciklit të dytë.

Në sajë të bashkëpunimeve çdo vit zhvillohen konferenca ndërkombëtare me tematikë letrare, gjuhësore, kulturore dhe përkthimore, si edhe aktivitete kulturore me studentë. Kjo punë është zhvilluar paralelisht dhe me shkëmbime të stafit akademik nga të dyja palët në fushën e mësimdhënies, si edhe në trajnime të pedagogëve.

Me studentët e Degës së Gjuhës Greke janë zhvilluar kurse verore në Universitetin e Janinës dhe Aristotelio të Selanikut, si edhe shkëmbime të studentëve në kuadrin e programit Erasmus+.

# Çfarë prespektive

## ka diploma ime?

Diplomat e FGJH-së ju japin mundësi të shumta punësimi brenda dhe jashtë vendit.

Për të përmbushur misionin final, FGJH-ja shërben si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës, duke krijuar kontaktet e duhura me punëdhënës potencialë.

Programet e ofruara nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja i përgatisin studentët me kompetenca në gjuhë, letërsi dhe kultura të ndryshme të huaja, për t'i bërë ata anëtarë të ditur dhe të ndjeshëm të shoqërisë globale.

Nga FGJH-ja janë diplomuar studentë, të cilët janë shquar për kontributin e tyre në fusha të ndryshme dhe të shumëllojshme të veprimtarisë profesionale dhe shoqërore, si në sektorin publik, kryesisht në politikëbërie, përkthim dhe interpretim, gazetari, diplomaci, mësimdhënie në nivele të ndryshme dhe në sektorin privat, nëpërmjet bizneseve të tyre të suksesshme.

Mësues i gjuhës së huaj pranë institucioneve arsimore publike e private.

Mësues i qendrave të gjuhëve të huaja.

Punonjës i zyrave të marrëdhënive me jashtë dhe me publikun në të gjitha institucionet publike dhe private.

Punonjës i ambasadave shqiptare në botë apo i atyre të huaja në Shqipëri.

Punonjës i mediave të shkruara e vizive.

Punonjës në Info-point turistike pranë bashkive në të gjithë vendin.

Përkthyes pranë shtëpive botuese, zyra avokatie, noteriale, etj.

Guidë turistike në muze, qendra historike e kulturore.

Punonjës në institucione që lidhen me arsimin, si Ministri, Instituti i Kurrikulave; Instituti Pedagogjik; Drejtori Arsimore.

Studiues dhe mediator kulturor.

## Si organizohet një vit akademik?



Për më shumë vizitoni në web linkun:  
<http://fgjh.edu.al/struktura-akademike/>

Data për fillimin e vitit akademik përcaktohet me Vendim të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Struktura mësimore është e ndarë në 2 semestra:

- Semestri I nis me procesin mësimor dhe pasohet nga sezoni i provimeve të dimrit.
- Semestri II vijon me procesin mësimor dhe pasohet nga sezoni i provimeve të verës.

Në vitin akademik janë 3 sezona të rregullta:  
i dimrit, i verës dhe i vjeshtës.

Në raste të veçanta, mund të hapen edhe 2 sezona shtesë, me kërkesë të Këshillit Studentor.

## Rregullore të Institucionit

**E drejta për informim është një nga të drejtat tuaja themelore. Ushtroni atë!!!**



Këshilli Studentor i fakultetit është organizim i pavarur i cili përfaqëson dhe mbron interesat e studentëve të FGJH-së në të gjitha programet e studimit.

KSFGJH përbëhet nga studentë të zgjedhur në mënyrë demokratike. Qëllim i punës së tij është organizimi në bazë rregullash:

- për të arritur rezultate sa më të larta,
- për të rritur cilësinë e mësimnxënies,
- për të ndihmuar studentët që kanë nevojë si në aspektin mësimor ashtu edhe në atë të përfaqësimit,
- për të nxitur frymën e bashkëpunimit me pedagogët,
- për të nxitur punën kërkimore shkencore,
- për të përfaqësuar FGJH-në sa më denjësisht në rritjen e emrit dhe të vlerave të institucionit.

Në FGJH të gjithë rregulloret dhe procedurat në fuqi të institucionit janë lehtësisht të aksesueshme edhe nga ju.

Për të lexuar Rregulloret, Udhëzimet, Strategjitë apo pjesën ligjore, vizitoni faqen zyrtare të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja duke klikuar në linkun:

<https://fgjh.edu.al/legjislacioni/>  
<https://unitir.edu.al/rregullore-ut/>



**RREGULLAT**

# Apliko për Bursë!

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, si pjesë e Universitetit të Tiranës, akordon Bursa Ekonomike të ofruara nga Buxheti i Shtetit.

FGJH-ja në strategjinë e tij ka në qëndër studentët dhe zhvillimin e tyre. Përgjegjësia kundrejt tyre është e madhe, jo vetëm për t'i garantuar atyre një arsim cilësor, por gjithashtu edhe për të ndihmuar çdo student të ketë mundësinë të jetë pjesë e Fakultetit tonë, duke i ofruar atyre bursa të ndryshme.

Bursat janë të ndara sipas kategorive më poshtë:

## ❖ Jashtë kriterit ekonomik

- Studentë me aftësi ndryshe ose kushte mjekësore të vërtetuara nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP);

- Studentë që i kanë të dy prindërit pensionistë ose njërin prind pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton;

- Studentë që i kanë të dy prindërit me aftësi ndryshe;

- Studentë të Komunitetit Rom;

- Studentë të ish të dënuarve dhe të përndjekurve politik;

- Fëmijë të policëve të rënë në krye të detyrës.



## ❖ Sipas kriterit ekonomik

- Studentë, familja e të cilëve trajtohet me ndihmë ekonomike si familje në nevojë;

- Bashkëshortët që kanë fëmijë dhe janë të dy studentë.

## ❖ Sipas kriterit të mesatares

- Bursat e Ekselencës ku përfitojnë studentët me mesatare mbi 9.

Për informacion më të detajuar lidhur me këto bursa, lexoni përditësimet në faqen Web Link:

[www.fgjh.edu.al](http://www.fgjh.edu.al)

Gjithashtu në faqen zyrtare të facebook në linkun:

[Fakulteti i Gjuhëve të Huaja i UT-së - Faqja zyrtare - Home | Facebook](#)

**Vendi i aplikimit është Zyra e Informacionit dhe Zyra e Financës**

**Afatet e dorëzimit të aplikimeve dhe kriteret, publikohen pas njoftimeve zyrtare.**



## Si të aplikoj për Bursë Erasmus+?

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja si pjesë e Universitetit të Tiranës është pjesë e programit “Erasmus+”, të lançuar nga Bashkimi Europian, i cili synon ndër të tjera krijimin e mundësive të studimit, mësimdhënies dhe trajnimit jashtë vendit në periudha të shkurtra. Llojet e mobilitetit të ofruara nga ky program, përfshijnë shkëmbimin e studentëve për studime në të tri ciklet e studimit: Bachelor, Master dhe PhD.

Në kuadër të programit të Bashkimit Evropian Erasmus+ dhe të programeve të tjera të ngjashme të financuara nga partnerët tanë mbështetës, studentët mund të thellojnë studimet në universitete të tjera prestigjioze jashtë vendit.

Studentët tanë kanë të drejtë të përfitojnë çdo vit nga thirrjet e ndryshme për mobilitete në universitetet Evropiane.

- Ndiqni thirrjet për mobilitet në web UT sipas linkut: [Erasmus + Archives - Fakulteti i Gjuhëve të Huaja \(fgjh.edu.al\)](http://Erasmus + Archives - Fakulteti i Gjuhëve të Huaja (fgjh.edu.al))
- Plotësoni aplikimin Learning Agreement
- Kontaktoni me Koordinator Akademik Erasmus+ në nivel Fakulteti me Zv. Dekan për Ciklin e Dytë të Studimeve Dr. Drita Rira, Koordinatore akademike Erasmus+ dhe marrëdhëniet me jashtë.



E-mail: [drita.rira@unitir.edu.al](mailto:drita.rira@unitir.edu.al) / [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)  
Orari: 09:00-15:00, nga e hëna në të premte.



Fakulteti i Gjuhëve të Huaja përfiton nga një numër i madh marrëveshesh ndërinstitucionale që Universiteti i Tiranës ka nënshkruar me universitetet më në zë të Evropës.

Për informacion më të detajuar klikoni në linkun: [Programe Erasmus - Fakulteti i Gjuhëve të Huaja \(fgjh.edu.al\)](http://Programe Erasmus - Fakulteti i Gjuhëve të Huaja (fgjh.edu.al))

Mobilitetet e ofruara do të ndikojnë ndjeshëm në rritjen e njohurive, rritjen e kualifikimit dhe eksperiencës suaj, njohjen dhe sigurimin e një literature bashkëkohore të nevojshme si dhe në krijimin e kontakteve personale apo institucionale për mundësi bashkëpunimi me studentë/kolegë apo universitete të tjera.

## Dokumentet kryesore në aplikim për mobilitete Erasmus+ janë:


- CV (në gjuhën që do të zhvillohet programi i studimit);
- Kopje e Pasaportës;
- Lista e notave (e përkthyer dhe noterizuar në gjuhën që do të kryhet programi i studimit);
- Vërtetim studentit (i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën që do të kryhet programi i studimit);
- Letër Motivimi (në gjuhën që do të kryhet programi i studimit);
- Certifikatë e gjuhës së huaj.

## Platformat elektronike që fakulteti ynë përdor

### “Microsoft Teams”



Ju keni mundësi të komunikoni me pedagogët tuaj edhe nëpërmjet platformës “Teams” për të shkarkuar leksione, detyra apo materiale për çdo lëndë.



Në platformën “Teams” do të gjeni edhe informacione në lidhje me çdo trajnim apo aktivitet që do të zhvillohet përgjatë vitit akademik.

Shkarkoni në telefon ose në kompjuterin tuaj personal aplikacionin falas “Teams”.



Për të hyrë në këtë platformë, pasi të keni kryer regjistrimin si student të fakultetit tonë, ju do të pajiseni me kredencialet tuaja universitare nga departamenti përkatës.



### Platforma “e-Student”



Kjo platformë është e lidhur me platformën “eAlbania”. Nëpërmjet këtij sistemi studentët do të kenë mundësi:

- të informohen mbi notat dhe lëndët;
- të aplikojnë për nxjerrjen e listës së notave;
- të aplikojnë për vërtetim studentit, nëpërmjet eAlbania.

Platforma e-Studenti lehtëson punën e pedagogëve dhe i vjen në ndihmë studentëve për të aksesuar në informacione të vlefshme për ta.

Studentët tanë pajisen me kredencialet e tyre, të cilat gjenerohen nga IT e Fakultetit.

Për t’u bërë pjesë e platformës klikoni në linkun:

[http://e-student.unitir.edu.al/e\\_student\\_ut](http://e-student.unitir.edu.al/e_student_ut)



# Zyra e Këshillimit të Karrierës

Zyra e Këshillimit të Karrierës ka në fokus të saj nxitjen e bashkëpunimit me studentët dhe synon të realizojë lidhjen mes studimeve akademike dhe mundësive të punësimit për studentët e diplomuar në FGJH. Kjo zyrë u krijon atyre mundësi të promovohen në kompani, organizata si edhe shoqata të ndryshme të interesuara për punëmarrës.

Zyra e Këshillimit të Karrierës organizon dhe monitoron Praktikën Profesionale dhe Panairin e Punës, si edhe udhëzon studentët për zhvillimin në karrierë, duke u përqëndruar në interesat personale të studentëve, si dhe harmonizimin e tyre me kërkesat për punësim në tregun e punës.



Qëllimi i Zyrës së Këshillimit të Karrierës është të mundësojë mbështetjen dhe nxitjen e studentëve në zhvillimin e potencialit të tyre për një qasje më të mirë me risitë e kërkesave të tregut dhe synon të rrisë numrin e të punësuarve në fushën e tyre të studimit.

Pjesë e misionit të Zyrës së Këshillimit të Karrierës është edhe përfshirja e studentëve në:

- ❖ **Workshope**
- ❖ **Trajnime**
- ❖ **Open Day**
- ❖ **Panaire Pune**
- ❖ **Takime të Hapura**

Zyra e Këshillimit të Karrierës organizon leksione të hapura me tematika të ndryshme si:

- ❖ **Krijimi i një CV-je**
- ❖ **Shkrimi i Letrës së Motivimit;**
- ❖ **Përgatitja e studentëve për intervista pune, etj.**

## Kontakte

E-mail: [keshillimkarriere.fgjh@unitir.edu.al](mailto:keshillimkarriere.fgjh@unitir.edu.al)

E-mail: [hensione.berhomi@unitir.edu.al](mailto:hensione.berhomi@unitir.edu.al)

Facebook: [FAKULTETI I GJUHEVE TE HUAJA TIRANE](https://www.facebook.com/FAKULTETI_I_GJUHEVE_TE_HUAJA_TIRANE)

Web: <https://fgjh.edu.al/>

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Kati i parë.



Dega e Cilësisë dhe Kurrikulave në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, është përgjegjëse për kontrollin, vlerësimin, garantimin dhe përmirësimin e cilësisë në FGJH dhe të programeve të studimit që ofron.

Kjo zyrë bashkëpunon dhe shkëmben eksperiencë me njësitë kryesore të vlerësimit të cilësisë me Universitetet e huaja, më ngushtësisht me Universitetin e Poitiers-së, në Francë si dhe me ish-studentë, sot pjesë e ALUMNI.

Nëpërmjet këtij bashkëpunimi, NJSBC i vjen në ndihmë të gjithë studentëve të cilët kryejnë shkëmbime studimi me Universitetet ndërkombëtare.

## Dega e Cilësisë dhe Kurrikulave në FGJH

- Mbështet dhe ofron sigurimin e cilësisë në mësimdhënie.
- Vlerëson përfshirjen e studentëve në procesin e të nxënës.
- Siguron promovimin e kulturës së cilësisë nëpërmjet komunikimit të vazhdueshëm me të gjitha strukturat dhe studentët.
- Planifikon dhe organizon vlerësimin e brendshëm të cilësisë së programeve të studimit.
- Evidenton dhe ndjek problematikat e lidhura me cilësinë e mësimdhënies.
- Organizon dhe ndjek zhvillimin e pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies për çdo program studimi. (2 herë në vit) si edhe atë institucional.
- Bën vlerësimin e performancës të personelit akademik.
- Realizon studime për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të studimit.
- **Ofron hapësirë e ndihmës së studentit drejt suksesit.**

## Kontakt

Email: [njsbc.fgjh@unitir.edu.al](mailto:njsbc.fgjh@unitir.edu.al)

klikoni në linkun: <https://fgjh.edu.al/zyra-e-vleresimit-te-cilesise-dhe-kurrikules/>

## Si të jem pjesë e Projekteve në FGJH?

Dega e Projekteve është njësi mbështetëse e dedikuar për ndërtimin e partneritetit në projekte kërkimore e zhvilluese, që mbështeten nga BE apo fondacione të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në thirrjet e shpeshta për projekte, stafi i fakultetit bën pjesëmarrës në grupin e punës, studentë aktivë të fakultetit. FGJH-ja nxit shpirtin sipërmarrës e inovativ të studentëve duke ndikuar në zhvillimin e një mjedisi motivues dhe pozitiv për studentët.

Ne mirëpresim projekt-idetë e studentëve tanë, për t'i orientuar ata drejt suksesit, me ndihmën e bashkëpunëtorëve të FGJH-së.

**Ndiqui rrjetet sociale të FGJH-së,  
për thirrje të ndryshme dhe  
motivohuni për të vënë në jetë  
idetë tuaja!**

Kontakt:

email: [vasilika.bezhani@unitir.edu.al](mailto:vasilika.bezhani@unitir.edu.al)

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja i UT-së – Faqja zyrtare web  
në likun: <https://fgjh.edu.al/dega-e-projekteve/>

Facebook: “Fgjh- Zyra e Projekteve”

në likun: <https://www.facebook.com/fgjh.zyraeprojekteve>



# PANAIRI I PUNËS - FGJH



Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, në startegjinë e tij për përmirësimin e programeve të studimit, e ka sfidë të tijën kualifikimin sa më të mirë të studentëve në specialitetet e tyre të studimit e bashkëpunimin më të ngushtë me bizneset dhe institucionet e ndryshme, për të përshtatur sa më mirë programet me tregun e punës si edhe për të pasur fleksibilitet më të madh gjatë karrierës profesionale të studentëve.



Fakulteti i Gjuhëve të Huaja organizon “Panairin e Punës” çdo vit ku marrin pjesë shumë kompani, organizata, institucione arsimore, shtëpi botuese, agjenci turistike, apo biznese të cilët paraqesin oferta pune për studentët tanë.

Panairi i Punës shërben gjithashtu si një pikë takimi mes studentëve dhe kompanive të ndryshme të interesuara për punësim, studime dhe praktika.



# Panairi Work & Study



Fakulteti i Gjuhëve të Huaja merr pjesë në Panairin e Edukimit Work and Study, i cili zhvillohet në 12 qarqe të Shqipërisë

Në stendat e FGJH-së maturantët njihen me programet mësimore, bursat, mundësitë e shkëmbimeve Erasmus+ si edhe mundësitë që ofton tregu i punës për të ardhmen.



# Si të bëheni pjesë e aktiviteteve në shkollë?

Përfshirja në klubet ekstrakurrikulare, mund të jetë një nga periudhat më të bukura të kohës suaj në universitet. Pavarësisht rezultateve që merrni në provime, në rritjen tuaj personale, ka gjithmonë një aktivitet ku ndiheni mirë dhe shprehni hapur talentin tuaj.

Klubet që mund të zgjidhni ju lidhin me një rrjet të gjerë njerëzish dhe profesionistësh, e për më tepër me shumë mundësi ju vënë në kontakt edhe me punëdhënësin tuaj të ardhshëm.

Ajo që ka rëndësi është përfshirja! Për mirëqënien tuaj personale ka gjithmonë një aktivitet ku mund të ndiheni mirë dhe të shprehni hapur talentin tuaj.

FGJH-ja ka aktivë 10 klube me përmbajtje artistike, sportive, vullnetare e inovatore të cilat janë:



**KLUBI I MUZIKËS**



**KLUBI ARTIT**



**KLUBI I VULLNETARIZMIT**



**KLUBI I AMBIENTALISTËVE**



**KLUBI DEBATIT**



**KLUBI ICT**



**KLUBI SPORTIV**



**KLUBI LETRAR**



Regjistrohuni në linkun:

<https://forms.office.com/r/vTNak0nGAP>

Ju mirëpresim!

# SHKOLLAT VERORE DHE DIMËRORE

Shkollat Verore dhe Dimërore sjellin më afër studentëve praktikat më të mira të integrimit të kurrikulës me kërkesat e tregut të punës. Gjithashtu këto shkolla synojnë t'u mundësojnë studentëve të interesuar përvetësimin e gjuhëve që ata zgjedhin dhe njohuri që kanë të bëjnë me çështje historike, gjuhësore, letrare dhe trashëgiminë kulturore.

Studentët kanë mundësi të shohin nga afër se sa profesione të bukura do të ushtrojnë në të ardhmen, duke iu referuar guidave turistike, ciceronëve, agjentëve kulturorë dhe turistik, përkthyesëve, etj.

## Shkolla Verore e Turizmit dhe e Kulturës



## Shkolla Verore e Gjuhës Bullgare



Me përfundimin e Shkollës Verore apo Dimërore pjesëmarrësit pajisen me certifikata pjesëmarrjeje, të lëshuara nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja.

## Shkolla Verore e Gjuhës Osmane



## Shkolla Dimërore e Gjuhës Kineze





# PRAKTIKA MËSIMORE



Praktika profesionale (intership) zhvillohet gjatë studimeve master dhe kohëzgjatja përcaktohet në strukturën mësimore për çdo vit akademik.

Praktika profesionale u siguron studentëve vënien në praktikë të teorisë së përfutur gjatë mësimnxënies.

## Master i Shkencave: “Mësuesi e Gjuhës së huaj për Arsimin e Mesëm të Lartë”

Studentët e kryejnë praktikën profesionale pranë shkollave të arsimit parauniversitar, me qëllim asimilimin e metodave dhe teknikave të mësimdhënies, me praninë dhe mbështetjen e një mësuesi me përvojë. Për më shumë informacion klikoni në këtë link:

<https://fgjh.edu.al/category/praktika-mesimore-master-mesuesi/>



## Master i Shkencave: “Përkthim Teknik-Letrar dhe Interpretim”

Studentët e kryejnë praktikën pranë Bashkive, Ambasadave, Televizioneve, Shtëpive Botuese, Studiove të Përkthimit dhe Organizimit të Eventeve, Studiove të avokative, etj.

Për më shumë informacion klikoni në këtë link:

<https://fgjh.edu.al/category/praktika-mesimore-master-perkthim-teknik-letrar/>



Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 dt. 22.07.2015, studentët që ndjekin studimet në ciklin e dytë kanë detyrimin të kryejnë praktikën mësimore e profesionale pranë një Institucioni i cili ka lidhur marrëveshje me Fakultetin.

FGJH-ja ka nënshkruar marrëveshje të shumta me institucione publike dhe private duke u krijuar studenteve mundësi të ndryshme zgjedhje. Lista e bashkëpunimeve gjendet e publikuar në faqet zyrtare të FGJH-së në këtë link:

<https://fgjh.edu.al/lista-e-marreveshjeve-te-nenshkruara-nga-fakulteti-i-gjuheve-te-huaja/>

## Master i Shkencave: “Gjuhë dhe Komunikim Ndërkulturor e Turistik”

Studentët e kryejnë praktikën në institucione të ndryshme publike dhe private, si Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Ministria e Jashtme, Ministria e Kultures, Turizmit, Muze, Agjenci Turistike, etj. Për më shumë informacion klikoni në këtë link:

<https://fgjh.edu.al/category/praktika-mesimore-master-gjuhe-dhe-komunikim/>



## Biblioteka fizike


Në mjediset e FGJH-së ndodhen dy biblioteka, që shërbejnë edhe si salla studimi për studentët.

Në këto biblioteka gjenden 20,227 libra dhe 15,965 tituj, që ndahen sipas kategorive në: libra studimorë, akademikë, artistikë, fjalorë si edhe revista të ndryshme shkencore.

Studenti anëtarësohet duke paraqitur një vërtetim nga sekretaria mësimore, që dëshmon se ndjek studimet në FGJH dhe më pas pajiset me kartën e anëtarësimit bibliotekës, për përdorimin e literaturës.

### Salla Argjiro

Disponon literaturë të gjuhës:  
angleze, italiane, spanjolle



### Salla Rozafa

Disponon literaturë të gjuhës:  
frënge, greke, sllavo-ballkanike



Kontakte:

[biblioteka.fgjh@unitir.edu.al](mailto:biblioteka.fgjh@unitir.edu.al)

## Biblioteka online



### Biblioteka digjitale JSTOR

JSTOR ofron më shumë se 12 milion artikuj të revistave akademike, 85 mijë libra dhe 2 milion dokumenta, në 75 disiplina.

Për të përdorur JSTOR duhet të:


- Hyni në llogarinë tuaj Office 365 të krijuar nga UT.
- Klikoni linkun:  
<https://www.jstor.org/>



### Biblioteka digjitale COBISS+

Fondi COBISS+ është krijuar për të gjithë përdoruesit, që kërkojnë informacione dhe materiale, të cilat janë në dispozicion në bibliotekat e Shqipërisë.

- Aksesohet bibliotekën COBISS+ në linkun:  
<https://plus.al.cobiss.net/opac7/bib/search>



### Biblioteka digjitale U-library

- Klikoni linkun:  
<https://ulibrary.rash.al/>

Teknologjia në duart e pedagogëve dhe studentëve të përkushtuar të FGJH-së, lehtëson procesin mësimor me paisje digjitale në:

- ❖ Laboratorët e Fonetikës;
- ❖ Laboratorët e Përkthimit;
- ❖ Laboratorët e Kërkimit Shkencor dhe i Integritimit të Teknologjive në Mësimdhënie;
- ❖ Qendrën e trajnimeve dhe inovacionit pedagogjik;
- ❖ Auditorët me tabela interaktive.



## Si të gjej një banesë studentit?

### Kampusi i “Qytetit Studenti”

Fakulteti ynë ndodhet në një nga zonat më të mëdha universitare të kryeqytetit. Studentët e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja kanë të drejtë të strehohen në Kampusin e “Qytetit Studenti”.

Kampusi ka 26 godina të rikonstruktura nga Bashkia Tiranë, me kushte bashkëkohore.



#### Kontakt:

Telefon: +35542376214 / 215

Email: [qytetistudentinr1@gmail.com](mailto:qytetistudentinr1@gmail.com)

Web: [qytetistudentinr1.gov.al](http://qytetistudentinr1.gov.al)

<https://www.facebook.com/qytetistudenti/>



Të gjitha dhomat janë të pajisura me internet pa pagesë, si dhe një sistem të plotë monitorimi kamerash në çdo rezidencë, për një jetë të sigurtë studentore.

Për më shumë vizitoni në web linkun:  
<http://fgjh.edu.al/struktura-akademike/>

### Qendra Studentore e Akomodimit Folë

Qendra më e re studentore e akomodimit “Fole” ka hapur dyert e saj duke ofruar një strehim të denjë, komod, infrastrukturë me standarte të larta, si edhe një mjedis të gjallë dhe tërheqës për të rinjtë, të sigurtë dhe gjithëpërfshirës për të jetuar dhe studiuar.

Synimi dhe objektivi ynë është t’i ofrojmë mbështetje studentëve për lehtësimin e jetës së tyre, rritjen personale dhe bashkëjetesën në një komunitet universitar.



Rezidenca “Fole” ofron shumë njësi shërbimesh si:

- Dhoma single/double
- Studio
- Apartamente
- Parking
- Transport i dedikuar
- Bibliotekë
- Supermarket
- Bar-Restorant
- Palestër & SPA
- Pishinë gjysëm-olimpike
- Lavanderi
- Siguri 24h/24

#### Kontakt:

Tel: 0696096613

Email: [e.duka@bolv.al](mailto:e.duka@bolv.al)

Adresa: Lagja: Laparakë, Rruga “29 Nëntori”

# Karta e Studentit

FGJH-ja në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, lehtëson procedurën e pajisjes me kartë, për studentët e saj, duke e sjellë këtë shërbim pranë mjediseve të Fakultetit.

Çdo student i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, pajiset me Kartë Studenti vetëm duke paraqitur një mjet identifikimi.



## Për çfarë shërben Karta e Studentit

Karta e Studentit është mjeti nëpërmjet të cilit studentët përfitojnë mjaft avantazhe, tarifa të reduktuara dhe oferta të dedikuara, si nga institucionet publike ashtu edhe nga subjektet private, si p.sh:

- Biblioteka
- Librari
- Jeta kulturore
- Shëndeti
- Abonetë

Studentët do të njoftohen për uljet e çmimeve, ofertat, promocionet, përfitimet nga shërbimet private dhe ato publike nëpërmjet adresës së emailit me të cilën regjistrohen për pajisjen me kartën e studentit.

Për lehtësitë që ofron Karta e Studentit, klikoni në linkun:

<https://www.kartaestudentit.al/>



## **FGJH-ja mbështet studentët me aftësi ndryshe**

Fakulteti ynë ka në strategjinë e tij sigurimin cilësor të mësimdhënies dhe fleksibiliten për studentët e regjistruar me aftësi ndryshe (si: studentë me dëmtime ortopedike, me paaftësi në shikim dhe studentë tetraplegjik).

Ne mbështesim studentët me aftësi ndryshe duke përmirësuar infrastrukturën dhe shërbimet si edhe duke ndikuar në rritjen e aksesit të këtyre studentëve në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja. Bazuar në sistemin arsimor gjithëpërfshirës dhe parimet e barazisë për mësimin gjatë gjithë jetës, FGJH mundëson formimin cilësor të të gjithë studentëve duke kontribuar në mirëqënien e tyre personale.



# Si të pajisem me kartën e shëndetit?



Vetëm me një vërtetim studentit të lëshuar nga sekretaria mësimore e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, çdo student mund të pajiset me kartën shëndetësore.



Në mjediset e FGJH-së, pranë zyrave të sekretarisë, ndodhet kutia e ndihmës së shpejtë.

## Ku mund të kërkoj shërbim mjekësor?

Pranë residencës studentore “Qyteti Studenti” ndodhet Qendra Shëndetësore, që ofron shërbim mjekësor 24 orë.

Shërbimet e ofruara pranë residencës studentore janë:

- Mjek familje
- Shërbim urgjence
- Gjinekologji
- Laborator
- Shërbim Psikologu



## Shërbimi i Psikologut në FGJH



Fakulteti i Gjuhëve të Huaja i kushton rëndësi shëndetit mendor dhe problematikave në përditshmërinë e studentëve.

Zyra e Psikologut në Fakultetin të Gjuhëve të Huaja bashkëpunon ngushtë me studentët dhe strukturat e FGJH-së për të kuptuar sfidat e jetës studentore, vështirësitë në të cilat ata gjenden çdo ditë dhe për t'i ndërgjegjësuar për vlerat që ata mbartin, për të krijuar kështu një mjedis gjithëpërfshirës ku të gjithë të ndihen të sigurt dhe të dëgjuar.

Kontakti:

[ilirjeta.metushi@unitir.edu.al](mailto:ilirjeta.metushi@unitir.edu.al)

[pamela.kofsha@unitir.edu.al](mailto:pamela.kofsha@unitir.edu.al)



**URGJENCA**  
127



**ZJARRFIKËSJA**  
128



**POLICIA**  
129

Sekretaria Mësimore është struktura bazë administrative në shërbim të procesit mësimor në fakultet. Ajo është përgjegjëse për organizimin dhe monitorimin e procesit gjithëpërfshirës të regjistrimeve të studentëve, si edhe mirëmban e arkivon çdo informacion, dokument dhe transkript lidhur me studentët.



*Cikli i parë*

Kryesekretare: [mimoza.kalo@unitir.edu.al](mailto:mimoza.kalo@unitir.edu.al)

Sekretari Mësimore Bachelor Gjuhë  
Angleze: [marsida.hoti@unitir.edu.al](mailto:marsida.hoti@unitir.edu.al)

Sekretari Mësimore Bachelor Gjuhë  
Gjermane, Greke, Frënge:  
[kestrin.korcari@unitir.edu.al](mailto:kestrin.korcari@unitir.edu.al)

Sekretari Mësimore Bachelor Gjuhë  
Italiane, Ruse, Turke, Spanjolle:  
